



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PRRENJAS  
KESHILLI I BASHKISË

Nr 48 Prot

Datë 07.10 /2020

VENDIM

NR. 04 DATË 26.12 2019

PER

MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NE  
BASHKINE PRRENJAS PER VITIN 2020.

-Mbeshtetur ne Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, - Ligji nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, - Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, - Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, - Ligji 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, - Ligji 8519 datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, i ndryshuar, - Ligji 9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar- Ligji 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, - Ligji 8224 dt 15.05.1997 “ per policin Bashkiake”- Ligji 8308 dt 18.03.1998 ‘per Transportin Rrugor “ I ndryshuar- Vkm 1064 dt 22.12.2010 “per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave “, Vkm 529 dt 08.06.2011 “ per percaktimin e kriterëve , te procedurës dhe te mynyres se dhenies me qera, enfiteoza apo kontrata te tjera te pasurise shteterore” , ligjin 8450 dt 24.02.1999 “ per perpunimin transportin dhe tregetin e naftes , gazit dhe nenprodukteve te tyre “, vkm nr 129 dt 18.03.1999 “per procedurat dhe kushte per dhenien e lejeve , dhe autorizimeve per tregetin e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre” ndryshuar me vkm 170 dt 25.04.2002 & nr 563 dt 27.08.2004 & nr 970 dt 02.12.2015.

Mbeshtetur ne ligjin 106/2017 Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 9632 dt 30.10.2006 “per sistemin e taksave vendore “ te ndryshuar , ligjin 68/2017 “per financat e vetqeverisjes vendore “, ligjin 95/2018 “ per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 9632”, VKM nr 132 dt. 07.03.2018 per metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “Ndertese” , e bazeve se taksës per kategorite specifike , natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenat per percaktimin e bazeve se taksës , si dhe te kriterëve dhe rregullave per vleresimin alternative te detyrimit te taksës.

Ne mbeshtetje te ligjeve te cituara me larte ndryshimet te paketes fiskale ne Bashkin Prrenjas per vitin 2020 jane per pasqyrimin e ndryshimeve ligjore , por dhe per pershtatjen e treguesve

te taksave e tarifave vendore , ndryshimeve administrative , shtrirjes gjografike e nivelit ekonomik te njesive perberese te Bashkise.

Te gjitha keto ndryshime do te sherbejne si instrument per rritjen e eficences administrative , profesionale dhe teknike te qeverisjes vendore , nepermjet rritjes se te ardhurave per te afruar sherbime me te mira per qytetaret.

Paketa fiskale e Bashkise Prrrenjas per vitin 2020 eshte perbere nga taksa e tarifa vendore te distinuara per juridiksionin e kesaj Bashkie .

Nivelet e taksave vendor jane kryesisht te miratuara ne ligj nga kuvendi i Shqiperis,por per nevoja te qeverisjes vendore ,keshilli Bashkiak ka te drejte te miratoje dhe taksa te perkohshme apo tarifa , qe i sherbejne nje objektivi te caktuar per permirsimin e situatave ne infrastructure e teritorit brenda juridiksionit te Bashkise.

Per kuptimin me te sakte te materialit te referuar meposhte , eshte e nevojshme dhe prezantimi i termave te saj si :

“Taksapagues” eshte cdo individ , person fizik ose juridik , vendas apo i huaj , i cii eshte i detyruar te paguaj taksat te percaktuara ne ligj.

“Takse” eshte pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme qe paguhet nga cdo person apo nepermjet nje agjenti qe ushtron nje te drejte publike apo perfiton nje sherbim public.

“Tarife “eshte nje pagese qe nje individ , person fizik apo juridik , ben drejtperdrejt apo nepermjet nje agjenti tek administrate tatimore . Pagesa behet ne shkembim te nje sherbimi specific te marre.

“Agjent i taksave dhe tarifave “eshte subjekti i cili , sipas kerkesave te ligjit eshte pergjegjes per llogaritjen , arketimin dhe transferimin ne llogarin e institucioneve perkatese te te ardhurave nga taksat dhe tarifate.Keshilli I bashkise ne mbledhjem e tije te dates26/12/2019

## **VENDOSI:**

### **1- MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE E TARIFAVE VENDORE NE TERITORIN E BASHKISE PRRENJAS PER VITIN 2020**

**Si vijon :**

#### **Grupi i Pare Llojet e taksave**

1. Taksa Taksa e Biznesit te vogel (Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin )
2. Taksa mbi Pasurin e palujtshme (mbi ndertesën,mbi token bujqesore, mbi truallin)
3. Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme
4. Taksa e ndertimit ne infrastrukture per ndertimet e reja
5. Taksa e tabeles
6. Taksa e regjistrimit te pervitshem te automjeteve te transportit rrugor
7. Taksa e fjetjes ne hotel
8. Taksa te perkohshme

#### **1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL**

Subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim vjetor nga 5 deri në 8 milionë, është 5% dhe për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 deri në 5 milionë lekë, është 0 lekë në vit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve , nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arketimin dhe transferimin në llogarite e buxhetit të qeverisjes vendore brenda datës 10 të muajit pasardhës ,kur janë arkëtuar të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qëndrore për shërbimin qe kryen merre nje komision ne masën 1%

të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e qeverisjes vendore. DRT njofton Bashkinë jo me pak se një here në 6 muaj për punën e bërë .

## 2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Taksën e pasurisë së palujtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizik ose juridik , vendas ose të huaj , pronar apo përdorues të pasurisë së palujtshme , në territorin e RSH, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive .

Detyrimin mbi taksën e pasurisë së palujtshme e ka, sipas rastit , pronar ose bashkëpronar , sipas pjesës që zoteron , apo përdorues i pasurisë së palujtshme , për pasuritë që nuk janë të paisur me dokument pronesie .

Në taksën e pasurisë së palujtshme përfshihen :

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi token bujqësore
- Taksa mbi truallin

### 2.a) Taksa mbi ndërtesën

- Taksën e ndërtesës i nënshtrohen individët, persona fizikë ose juridikë , vendas ose të huaj , personat që kanë aplikuar për legalizim , personat që janë në proces ndërtimi sipas lejes së ndërtimit , por të pa nbyllur në kohë .
- Vlera e taksës për të paguar për çdo njësi pronesie llogaritet si shumëzim i bazës së taksueshme me shkallën e taksës . Baza e taksueshme është vlera e pasurisë , e cila llogaritet si shumëzim i cmimit për meter katror me sipërfaqen e ndërtimit në meter katror.
- Taksa e ndërtesës llogaritet si detyrim vjetorë dhe pagesa e saj do të bëhet për çdo muaj ose me gjatë sipas marrëveshjes së arritur me një nga agjentët tatimorë.
- Shkallët e taksës së ndërtesës janë :
  - a. 0,005 % për ndërtesat për banim
  - b. 0,2 % për veprimtari ekonomikë
  - c. 30 % e shkallës së taksës përkatëse për të gjitha sipërfaqet ndërtimore , për të cilat zhvilluesi është paisur me leje ndërtimi dhe nuk e ka përfunduar në afat .
- Me 1 nëntor 2018 filloi sistemi i ri i taksës së ndërtesës me drejtorin e përgjithshëm të taksës së pasurisë e cila menaxhon regjistrin qendror të bazës së të dhënave dhe udhëheq nga pikëpamja metodologjike taksën e ndërtesës sipas të dhënave të marra nga OSHEE (censusi) .
- Zyra e tatimit-taksave është përgjegjëse për administrimin e taksës së ndërtesës , mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve , përfitson të dhënat në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurisë së palujtshme ( kadastra fiskale ) .
- Në paketën fiskale 2020 do të aplikohen koeficientët si më poshtë :
  - a. Cmimi për banim sipas aneksit 1 , me **41780** lek/m<sup>2</sup>
  - b. Cmimi për veprimtari ekonomikë sipas aneksit 2 pika me **62670** lek/m<sup>2</sup> pra 1.5 here më i lartë se cmimi i sipërfaqeve të banimit .
  - c. **Cmimi i reduktuar në 35 % për njësit administrative sipas pikës dh të aneksit 2 me 27157 lek/m<sup>2</sup> për njësit Qukes, Rrajce, Stravaj dhe fshatrat e ish-bashkisë Prrenjas .**
  - d. Cmimi për parkim të mbuluar, bodrume me **29246** lek/m<sup>2</sup> sipas pikës b aneksi 2 është 70 % e cmimit të sipërfaqeve të banimit sipas aneksit 1 .
  - e. Cmimi për veprimtari industrial prodhim , përpunim ose magazinim të mallrave industrial si fabrika , depo , magazine etj. me **20890** lek/m<sup>2</sup> është 50 % e cmimit të sipërfaqeve të banimit sipas aneksit 1.

- f. Cmimi per grumbullim , magazinim dhe ruajtje te prodhimeve bujqesore e blektorale dhe parkim te hapur me 12534 lek/m2 eshte 30 % e cmimit te siperfaqeve te banimit sipas aneksit I
- g. Per ndertesat e privattizuara me ligjin 7652 dt 23.12.1992 “per privatizimin e banesave shtetere “ , te ndryshuara , cmimi per m2 eshte 70 % e cmimit sipas zonave te tabelës , vetem ne rastin e shitjes se pare .
- Nisur nga ndryshimi i takses se ndertesës, ku per familjaret ka nje rritje ne 3-4 fishe dhe per veprimtarit ekonomike shkon me ulje , bazuar ne piken 3 te vkm 132 dt 07.03.2018 me + - 30 % i propozojme keshillit bashkiak :
- a. Zbritje te takses se ndertesës ne masen - 30 % per njesit administrative Qukes,Rrajc,Stravaj .
- b. Rritje te takes se ndertesës ne + 30 % per ish-bashkin Prenjas .

**c. TABELA E TAKSES SE NDERTESES SIPAS NJESIVE,PER BANIM**

Njësia Administrative	Cmimi referencë i miratuar	Shkalla e takses së miratuar		Vlera e takses për metër katror për banesat që përdoren/shrytëzohen për banim			
		familje	biznese	Shtëpi/ Apartamenti (1)	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Banesa të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)
Prenjas	41780	0.035 %	0.26%	14.62	10.24	4.39	10.24
Qukës	27157	0.035 %	0.14%	9.5	6.65	2.85	6.65
Rrajcë	27157	0.035 %	0.14%	9.5	6.65	2.85	6.65
Stravaj	27157	0.035 %	0.14%	9.5	6.65	2.85	6.65

**VEP.EKONIMIKE**

Njësia Administrative	Cmimi referencë i miratuar	Shkalla e takses së miratuar		Vlera e takses për metër katror për ndërtesat që përdoren/shfrytëzohen për zhvillim aktiviteti				
		familje	biznese	Njësi tregtimi dhe shërbimi (1.5)	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Njësi industriale, prodhimi, magazinimi (0.5)	Njësi që përdoren për bujqësi ose blegtori (0.3)
Prenjas	41780	0.035 %	0.26%	162.94	76.04	32.59	54.31	32.59
Qukës	27157	0.035 %	0.14%	57.029	26.6138	11.4059	19.0099	11.40594
Rrajcë	27157	0.035 %	0.14%	57.029	26.6138	11.4059	19.0099	11.40594
Stravaj	27157	0.035 %	0.14%	57.029	26.6138	11.4059	19.0099	11.40594

- Perjashtohen nga taksa e ndertesës sipas ligjit 106/2017 neni 22 pika 6 .
  - a. Pronat e shtetit
  - b. Pronat e shtetit te kaluar shoqerive publike shteterore
  - c. Ndertesa e banimit , qe shfrytezohen nga qiramarresi me qira te paliberalizuar
  - d. Banesa sociale ne pronesi te bashkive
  - e. Pasurit e palujtshme ndertesa , qe perdoren si banesa sociale
  - f. Ndertesa qe perdoren nga komunitetet fetare
  - g. Hotel me 4 dhe 5 yje
  - h. Ndertesa banimi te kryefamiljareve qe perfitojne pension pleqerise ose pension social , qe jane me banim ne fshat ose ne qytet , kur familja perbehet vetem me pensioniste .
  - i. Ndertesa banimi te kryefamiljareve qe trajtohen me ndihme ekonomike
  - j. Ndertesa kulturore
  - k. Perjashtohen nga taksa e ndertesës k/familjaret ose personat qe kane ne pronesi ndertesën dhe detyrimin per ta paguar , por eshte invalid sipas ligjit 8982 dt 12.12.2002 , udhezimit nr 6 dt 04.02.2003 “per invalitet”.
- Dekumentat qe vertetojne per perjashtimin nga taksa e ndertesës
  - a. Zyrat e ndihmes ekonomike per kryefamiljaret qe trajtohen me ndihme ekonomike , te dorzoje prane zyres se tatim-taksave , listen e kryefamiljareve me dt 30 te cdo muaji , duke filluar nga dt 30 dhjetor 2019 e ne vazhdim.
  - b. Per pensioniste , pa person tjetër , duhet te dorzohet , certifikata familjare, libreze pensioni ose vertetim nga sigurimet shoqerore .
  - c. Per qiramarresit , kontrata e qirase .
- Detyrimi per pagesën eshte detyrim vjetor ose mujor .
- Struktura pergjegjese per vjeljen e taksës eshte zyra e tatim-taksave dhe agjenti tatimor.

## 2.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në dynym, në pronësi të taksa paguesit. Niveli i taksës caktohet në lekë për dynym. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Aneksi 2 zona 3

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hek/vit
I	2800
II	2100
III	1400
IV	1350
V	1250
VI	1200
VII-X	1100

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Pas vetëdeklarimit Zyra e Tatim - Taksave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën.

Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Per familjet qe paguajn taksen mbi token bujqesore deri me 30 Qershor 2018 do te kene nje zbritje prej 30 % (vetem detyrimi i vitit 2020 , pjesa e debise do te paguhet 100%)

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Zyra e tatim taksave pranë Bashkisë Prrenjas dhe arketaret prane njesive Administartive .**

### **2.c) Taksa mbi truallin.**

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m2, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet gjate vitit fiskal. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Pas vetëdeklarimit zyra e tatim taksave mund të bëjë verifikimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përlllogaritet për të gjithë periudhën. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

<b>Klasifikimi sipas bashkive</b>	<b>Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët</b>	<b>Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi</b>
<b>Bashkia Prrenjas</b>	<b>0,14 lekë/m2</b>	<b>12 lekë/m2</b>

- Akt-detyrimet per taksen e pasuris se palujteshme per njesit administrative do te plotesohen dhe shprndahen deri me 28 shkurt 2020
- Pagesa do te kryhet prane arkes se njesis administrative
- Inspektori i ngarkuar per taksen e pasurise se palujteshme bashke me arketaret e njesive administrative do te ndjekin shperndarjen dhe vjeljen e detyrimit tatimor .
- Inspektori i ngarkuar nga sektori i Tatim-Taksave per tarifat e qytetit do te jete pergjegjesi per ndjekje dhe vjelje e ketyre detyrimeve .
- Përfshihen nga taksa e ndertesës invalitet bazuar ne ligjin 7889 dt 14.12.1994 “per statusin e invalitetit “ndryshuar me ligjin 8052 dt 21.12.1995 dhe 9143 dt 16.10.2003. Kur invaliti ushtron veprimtari private nuk perjashtohet nga taksa.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesin është zyra e tatim taksave pranë Bashkisë Prrenjas.**

### 3. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

- Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.
- Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Aneksi 3 zona 3	
Kategoritë e Ndërtesave	Njesia administrative bashkia Prrenjas
	<b>Zona 3 (Lekë/m<sup>2</sup>)</b>
I. Ndërtesa banimi	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
III. Ndërtesa të tjera	200

**Shënim :** Në të gjitha njësitë administrative të tjera zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, e cila në rolin e agjentit tatimor, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.**

### 4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
2. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit 1 – 3 % .
  - Per ndertimet familjare do te jete 1 %
  - Ndertimet per efekt biznesi 2 % .
3. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
4. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 % e vlerës së investimit. Për ndërtimet në proces legalizimi, objekt i dytë, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të llogaritet si ndërtimet e reja që trajtohen me Leje ndërtimi (Pika 2 dhe 3).
5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.





taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhen me anë të faturës për arkëtim, 25 % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.**

## 6. TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkise Prrenjas. Niveli i kësaj takse për Bashkinë Prrenjas është si më poshtë vijon:

### Aneksi 7 TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	Llojet e tabelave	Nj/matase	Bashki kat. I	Bashki kat.II	Bashki kat.III
I.	Takse tabelle per qellime identifikimi, te trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoren per te reklamuar veprimtarite e te treteve ( ku shenohet emri dhe/ ose aktiviteti I biznesit				
a	Deri ne 2 m2	leke/m2/vit			0
b	Mbi 2 m2 deri 10 m2				
	E thjeshte( pa ndricim)	leke/m2/vit			7000
	Me ndricim te thjeshte	leke/m2/vit			11500
	Elektronike	leke/m2/vit			15000
c	Mbi 10 m2 deri 20 m2				
	E thjeshte( pa ndricim)	leke/m2/vit			5950
	Me ndricim te thjeshte	leke/m2/vit			9775
	Elektronike	leke/m2/vit			12750
ç	Mbi 20 m2 deri 40 m2				
	E thjeshte( pa ndricim)	leke/m2/vit			3850
	Me ndricim te thjeshte	leke/m2/vit			6325
	Elektronike	leke/m2/vit			8250
d	Mbi 40 m2				
	E thjeshte( pa ndricim)	leke/m2/vit			2800
	Me ndricim te thjeshte	leke/m2/vit			4600
	Elektronike	leke/m2/vit			6000
II.	Tabele per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim				
	Tabele identifikuese	leke/m2/vit			120
III.	Tabele per qellime reklamimi e levizshme e palevizshme				
	E thjeshte( me/pa ndricim)	leke/m2/vit			13500
	Elektronike	leke/m2/vit			27000
IV.	Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndyshme te hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	Te te gjitha llojeve dhe permasave	leke/m2/vit			1000

Detyrimi i kësaj takse është vjetrore dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë në favor të bashkisë. Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

**Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është IKMT pranë Bashkisë Prrenjas bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është zyra e tatim taksave.**

**Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendosje table reklamuese është Policia Bashkiake.**

## 7. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel”.

### Aneksi 8

<b>Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel</b>	<b>Bashkia Prrenjas</b>
Hotelet 4-5 yje	105 lekë për natë fjetje
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë për natë fjetje

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është zyra e tatim taksave të Bashkisë Prrenjas.**

## 8. TAKSA TE PERKOHSHME VENDORE (neni 33 , te 9632)

### 1. Takse per Arsimin, neni 13, pika 6-7, 68/2017

Nr	Emertimi	Vlera
1	Baza e llogaritjes se taksës se perkohshme per cdo tatimpagues është vlera e taksës se pasurisë se paluajtshme te tatimpaguesit .	

2	Niveli i takses sipas pikes 1 do te jete .	35 %
3	Per subjektet qe nuk perfshihen te pika 1 , por jane te klasifikuar biznes i madh per transport udhetaresh e te tjera.	10 000 leke/viti
4	Per subjektet qe nuk perfshihen te pika 1 , per transport udhetaresh te klasifikuara si biznes i bogel .	5 000 leke/viti
4	Per subjektet qe nuk perfshihen te pika 1 , te klasifikuar biznes i vogel ne ish-bashkin Prrenjas apo njesit administrative .	3 000 leke/viti

## 9. Renta Minerare

Bazuar ne ligjin 9975 dt 28.07.2008 “ per taksat kombetare “ i ndryshuar Drejtorit Rajonale Tatimore dhe deget e doganave te cilet jane agjent tatimor , Brenda dt . 30 te cdo muaji dergojne informacion analitik prane drejtoris se pergjithshme te buxhetit ne Ministrin e Financave , per vleren e rentes minerare te mbledhur , subjektin tatimore dhe njesit e qeverisjes vendore , sipas formularit 9 .

Pjesa e te ardhurave nga renta minerare , 5 % te percaktuar me ligj , qe i takon njesise se qeverisjes vendore , shperndahet nga struktura pergjegjese te buxhetit ne Ministrin e Financave . Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorin rajonale te tatimeve/doganave , respective , dhe njesine e qeverisjes vendore , per masen e llogaritur te shperndarjes se te ardhurave nga renta minerale.Drejtoria Rajonale e tatimeve dhe Doganave paraqesin kerkese per transferimin e fondit ne degen perkatese te thesarit .

Dega e thesarit ku ndaodhet Drejtoria Rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon , duke perdorur metoden e transferimeve te brenshme ne sistemin informatizuar financiar te Qeverise.

## Grupi i dyte

### TARIFAT VENDORE

Llojet e tarifave subjekt i ketij vendimi jane :

- *Tarifa Pastrimi*
- *Tarifa Ndricimi*
- *Tarifa Gjelberimi*
- *Tarifa Parkimi dhe pajisje me laje transporti*
- *Tarifa ne sektorin e ndertimit dhe zhvillimit te teritorit*
- *Tarifa per dhenien e licencave (autorizimeve ) ne tregtim te karburanteve*
- *Tarifa per familjaret*
- *Tarifa per zenien e hapsires publike*

Ne baze te nenit 35 te ligjit 9632 dt 30.10.2006 Bashkia krijon te ardhura nga krijon tye ardhura nga tarifate vendore per:

- Sherbima publike qe ato afrojne (pastrim,gjelberim ,ndricim , etj)
- Te drejten e perdorimit te pronave publike vendore (psh tarife parkimi,tarifa perdorimi te shesheve vendore etj)
- Dhenia e licencave , lejeve , autorizimeve , leshimi i dokumentave etj.

Ne pergjithesi tarifate e sherbimeve percaktohen me synimin mbulimin e kostove te tyre .

Me vendosjen e tarifave nga Bashkia kemi ne considerate vendosjen ne lidhje te drejperdrejt midis tarifes dhe qellimit te perdorimit te saj, me qellim qe qytetaret te ndergjegjesohen dhe te ndjejne efektin e pageses se bere prej tyre.

Percaktimi i tarifes do te shoqerohet me publikim dhe njoftim qe personat , familjaret apo subjektet te njihen ne kohen e duhur.

### **Dhenia e licencave per tregëtimin e naftes,gazit dhe nenprodukteve te tyre**

Bashkia Prrenjas jep licence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkise Prrenjas.

Autorizimet jepen nga Bashkia Prrenjas për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon.

- Ne rruge nacionale      **100 000 leke /5 Vjet**
- Ne rruge rurale            **50 000 Leke/5Vjet**
- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe vajra lubrifikante      **2 000 000 lekë**
- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë **200 000 lekë.**

Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj licence dhe vjeljen e detyrimeve është IVMT në Bashkin Prrenjas.

Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Policia Bashkiake.

### **TARIFE PASTRIMI**

<b>I</b>	<b>Biznesi i Madh</b>	<b>VLERA</b>
	➤ <b>Per familjaret Tarif Pastrimi</b>	<b>200/leke /fryme/viti</b>
	➤ Për subjektet e ndërtimit seli administrative : • Biznes i madh	50.000 lekë/viti
	➤ Për subjektet B.M : • Regjistruar ne regjistrin e tatimpaguesve te medhenj (VIP)	100 000 leke/viti
	➤ Per subjektet me nipt sekondar – per cdo njesi shitje	30 000 leke/viti
	➤ Bankat e nivelit te dyte, Fondacioni, Spitale , Sigurim shoqerore , Ujsjelles kanalizime , Karburante ne rruge nacionale ,Supermarkete .	75 000 leke/viti
	➤ Hec-et,Tec-et,minierat,guroret ,Lende drusore,Karburante brenda qytetit .	100 000 leke/ viti
	➤ Hotele , Motele .	60 000 leke/vii
	➤ Markete , Karburante ne rruge Rurale .	40 000 lek/viti
	➤ Per subjektet e transportit Biznes i madh	30 000 lek/viti
	➤ Biznes i madh - te pa cituar me larte	30 000 lek/viti

	➤ Per subjektet qe zhvillojne aktivitet ne teritorin e bashkise nga tenderat ,per ndertim apo rikonstruksion ne rruge,shkolla,ujesjellesa e tj.jo rezident ne bashki .	6 000 lek/muaji
<b>KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET B.V</b>		
	Per cdo subject te b.v. - shitje me me pakice dhe shumice te artikujve industrial apo ushqimore ,Bar-kafe, sherbime profesione te lira etj.	5 000 leke/viti
	Servis automjetesh , OJQ shoqata e tj.	5 000 leke/viti
	Bar-Restorant,Hotele ,Motele,Lende drusore .	10 000 leke/viti
	Per biznes i vogel njesi administrative	5 000 lek/viti
	Per b.v. me nipt sekondare per cdo njesi shitje etj.	5 000 lek/viti
	Per autobuza mbi 8 + 1	10 000 lek/viti
	Per automjetet transporte udhetaresh 8 + 1	5 000 lek/viti
	Per automjetet transporte udhetaresh 4 + 1	3 000 lek/viti
	Per cdo subject b.v. te pa cituar me larte	5 000 lek/viti
	Per Ambulantet	
<b>II.</b>	<b>TARIFË PARKIMI</b> ( Qytet Prrrenjas )	
	➤ autovetura taksi 8 + 1 vende	5 000 lekë / viti
	➤ autovetura taksi 4 + 1 vende	3 000 lekë / viti
	➤ automjet transport malli deri 3,5 T (me ngarkesë)	1 500 lekë / viti
	➤ automjet transport malli mbi 3,5 T (me ngarkesë)	2 000 lekë / viti
<b>III</b>	<b>TARIF PER ZENIEN E HAPSIRES PUBLIKE</b>	Vlera
	➤ Tarife per tregun e lire ne qytetin Prrrenjas	30 lek/m2
	➤ Tarife per tregun e lire ne njesit administrative	20 lek/m2
	➤ Tarife per tavolinat jasht lokaleve ,pron publike	5 000 leke
	➤ Tarife per vendosje kende lojrash , pron publike	10 000 lek/muaji
	➤ Tarife per shesh funksional ,per te gjithë subjektet veprimtari Ekonomike ,Parkim etj.	50 lek/m2

➤ eekonomike

#### IV - TARIFË GJELBËRIMI ( Qytet Prrrenjas )

	➤ Per familjaret	250 lekë në vit/Familje
	➤ Spitali,	5 000 Leke/viti
	➤ Për subjektet e ndërtimit seli administrative :	5 000 Leke/viti
	• Biznes i madh	5 000 lekë/viti
	➤ Për subjektet B.M :	6 000 leke/viti
	• Te klasifikuar si VIP	
	ngjashtme me B.Madh + nipt sekondare + transport udhetaresh etj.	5000 leke/viti
	➤ Sigurimet shoqerore,ujsjells	5000 leke/viti
	➤ Per te gjitha subjekte Bizne i Madh te pa cituara me larte	5000 leke/viti

Per subjektet Biznes I vogel Bar – Restorane ,Hotele , Motele ( Qytet Prrenjas )	3 000 leke/viti
Per te gjitha subjektet B.Vogel Qytet Prrenjas )	2 000 leke/viti

## V - TARIFE NDRICIMI

	LLOJI I TARIFËS	VLERA
1.		200 lekë /fryme/vit
	➤ Spitali	10 000 Leke/viti
	➤ Për subjektet e ndërtimit seli administrative : • Biznes i madh	10 000 Leke/viti
	➤ Për subjektet B.M : • Te klasifikuara si VIP	10 000 Leke/viti
	➤ Per te gjitha subjekte Biznes i madhe + nipt sekondare + transport udhetaresh me autobus	10 000 Leke/viti
	➤ Sigurimet shoqerore,ujesjells	10 000 Leke/viti
	➤ Per te gjitha subjektet Biznes I Vogel (Qytet Prrenjas)	5 000 leke/viti
	Transport udhetaresh 8+1	3 000 leke/viti
	Transport udhetaresh 4+1	2 000 leke/viti

- Perjashtohen nga tarifat familjare (pastrim,ndricim 200 + 200 lek/frym) invalitet qe nuk perjashtohen tek taksa e ndertesës , jane pjestare ne trugun familjare , por jo k/familjare .

**VI- Tarife e ujit te pishem ne njesit administrative Rrajc,Qukes,Stravaj,Prrenjas-fshat,Rashtan ,lagje e balles per vitin 2020.**

<b>A</b>	Konsumator Familjare me Kontaktor	26/leke/m3
<b>B</b>	Konsumator Public,Privat me Kontator	60/leke/m3
<b>C</b>	Tarif Fikse Sherbimi	100/leke/muaji/klent
<b>D</b>	Konsumator Familjare pa Komntator	300/leke/muaji/klent

**VII- Tarife reklamimi te bizneseve ne revisten e Bashkise “qyteti im “ dhe ne faqen e internetit , si dhe dhenie leje non stop.**

Vendi	Reklamim me ngjyra
Faqe e plote	25 000 lekë
½ e faqes	12 500 lekë
Leje Non Stop	10 000 lek/viti

## VIII – TARIFA TE TJERA

- Tarifa per transport mallrash nga te tretet ne qytetin Prrenjas , Leje Hyrje ose Certifikat hyrje – me tonazh deri ne 3.5 ton 500 leke/muaji ose 6 000 leke/viti, mbi 3.5 ton 1 000 leke/muaji ose 10 000 leke/viti .
- Tarife per subjektet veprimtari ekonomike Kabllori **100 leke/abonent/viti** .
- Tarife per kalimin kabllor nentoksore ,ne tubacione me investim te subjekteve ,por me leje nga Bashkia **2 lek/ml/viti**.(Ligji 95/2018 neni 12 )
- Tarife per kalimin kabllor nentoksore ne tubacionet e vendosura nga Bashkia **4 lek/ml/viti**.
- Tarife per vaditjen e takave bujqesore :
  - a) Ne njesit administrative qe do te kete sherbim me punonjesit e saj **200 leke/dy**.
  - b) Ne njesin administrative Rrajce fshati Katjel **300 leke dy** .

### **Analiza te tjera per taksat dhe tarifat 2020**

- Të gjithë subjektet që regjistrohen për herë të parë prej datës 1 janar 2020 e në vazhdim për vendosjen e tarifave vendore (pastrim , ndriçim, gjelbërim) do të bëhet vlerësimi nga zyra duke përdorur metoda alternative. Në përdorimin e metodave alternative të vlerësimit tatimor administrata tatimore vendore bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, situatën e tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

#### **Struktura e ngarkuar për përcaktimin e tarifave vendore (pastrim, ndriçim, gjelbërim) është Zyra e tatim taksave ne Bashkine Prrenjas.**

- Per vitin 2020 eshte planifikuar nje takes e perkohshme per arsimin , granti per arsimin dhe te ardhurat vendore nuk perballojne sherbimin ne arsim dhe lind si domosdoshmeri vendosje e nje takes te perkohshme ndaj subjekteve me veprimtari ekonomike ne teritorin e Bashkise.
- Tarifat për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim janë detyrime vjetore të tatimpaguesit ekzistues dhe për ata që regjistrohen rishitaz për periudhën e mbetur deri në fund të vitit ushtrimor. Për vendosjen e tarifave vendore (pastrim , ndriçim, gjelbërim) do të bëhet vlerësimi nga zyra, ky vlerësim bazohet në dokumentacionin dhe informacionin që disponon, duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat konkrete të biznesit, situatën e tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm, me synim rikarakterizimin e transaksioneve dhe llogaritjen sa më të saktë të detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.
- Tatimpaguesi qe nuk paguan detyrimet tatimore brenda afatit të parashikuar,sipas nenit 114 te ligjit 9920 do të paguajë shumën e detyrimit tatimor + gjoben të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

#### **Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim për subjektet është Zyra e tatim taksave ne Bashkine Prrenjas.**

**Policia Bashkiake mbeshtet inspektorët e Tatim-Taksave per vjeljen me force te detyrimit tatimor kur detyrimi nuk eshte paguar ne afat.**

**Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tavolina jashtë lokaleve është IVMT e Bashkise Prrenjas dhe për vjeljen e kësaj tarife është Zyra e tatim taksave ne Bashkine prrenjas.**

**Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për ushtrim aktiviteti me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike është Policia Bashkiake.**

- Përsa i përket Tarifës për m2 mur të jashtëm për çdo ndërtesë.

**Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife, është Drejtoria e Urbanistikës ne Bashkin Prrenjas.**

- Përsa i përket zënies së hapësirë publike është detyrim i tatimpaguesve, apo ambulanteve ne tregun e lire sipas tarifave të percaktuara me lartë .

**Struktura e ngarkuar për dhënie leje për zënie të hapësirave publike, matjen dhe përlllogaritjen e kësaj tarife është Drejtoria e Urbanistikës dhe për vjeljen e kësaj tarife është Zyra e tatim taksave ne Bashkin Prrenjas.**

**Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për zënie hapësirë publike është Policia Bashkiake.**

- Tarifë “leje non stop” është tarifë e cila do të paguhet nga subjekte të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbas orës 23.00 dhe që do të pajisen me lejen përkatëse për të zhvilluar aktivitetin e tyre mbas këtij orari. Leja non stop do tu jepet atyre subjekteve të cilët më parë e kanë kërkuar këtë leje nga Bashkia Prrenjas.

**Struktura e ngarkuar për dhënie “leje non stop” përlllogaritjen e vlerës së kësaj tarife dhe vjeljen e detyrimit është IVMT ne Bashkin Prrenjas.**

**Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje dhe mos zbatim të saj (bazuar në rregulloret përkatëse) është Policia Bashkiake**

- Tarifat për familjaret apo subjekte do të aplikohet vetëm aty ku merret ky shërbim . Pagesat do të behen për familjaret me një kështë brenda vitit kalendarik , për subjekte mundet të paguhet në dy kështë , kështë parë deri me 30.04.2020 dhe kështë i dytë deri 30.09.2020 ku të jenë likujduar të gjitha detyrimet .
- Leje hyrje në qytet për transport mallrash jepet nga drejtoria e shërbimit me sektorin e tatim-taksave .Kontrolli dhe penalitet policia bashkiake Prrenjas .
- Tarifat për kalimet kabllorë nëntokësore llogariten nga Drejtoria e urbanistikës .Për vjeljen e kësaj tarife është sektori tatim-taksave bashkia Prrenjas .
- Tarife vadije e tokave bujqësore ,procedurat e organizimit për venien në efikasitet të kësaj tarife është Drejtoria e Bujqësisë Bashkia Prrenjas . Sektorin e tatim-taksave ndjek të ardhurat nga kjo tarifë.
- Taksapaguesit biznesi i vogël apo i madh janë të detyruar të paguajnë tarifën dhe taksat vendore mbi biznesin për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin e tarifave dhe taksave vendore të percaktuara për llojin e biznesit sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë. Bizneset nën administrimin e të njëjtës taksapagues që ushtrohen në një vendndodhje (në një godinë) do të tatonen gjithnjë si vendndodhje biznesi më vet.
- Një "vendndodhje biznesi" është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godinën e ndryshme.Për shembull: a) Kur veprimtari të ndryshme ekonomike kryhen nga një taksapagues në të njëjtën dhomë,konsiderohen si një vendndodhje e një biznesi.b)E njëjta veprimtari ekonomike kryer nga një taksapagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen një biznes, pra konsiderohen si një "vendndodhje biznes c) Dy veprimtari të ndryshme ekonomike të kryera nga një taksapagues në dy dhoma, që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy "vendndodhje biznes".



## **TARIFA TË SHËRBIMIT ADMINISTRATIV TË BASHKISE PPRENJAS**

### **1) TARIFA TË SHËRBIMIT ARKIVOR, VËRTETIME NGA ZYRAT DHE KOMISIONE PËR SHËRBIMIN PRANË ARKËS SË BASHKISE DHE NJESIVE NE VARTESI.**

- Tërheqje Vendime të Këshillit Bashkiak dhe Vendimeve për miratim leje ndërtimi/Zhvillimi **500 lekë**
- Tërheqje e gjithë dokumentave të tjera përveç atyre të sipërpërmendura dhe njehsim i tyre me originalin nga Arshiva e Bashkise Pprenjas **50 lekë/dokumenti.**
- Vertetim per subjektet qe marrin pjes ne tender qe nuk kane detyrime ndaj Bashkise Pprenjas **500 leke**
- Terheqje vertetime Banor,Aktiviteti privat,likujdim detyrimesh,ndihme ekonomike,toke,ndrrim emri,leje banimi,ndarje nga trangu familjar,si dhe cdo lloj vertetimi tjeter. **50 Leke /cope.**
- Deklarata vjetore e ndihmes ekonomike **200 leke/vite**
- Tarifa per arzhonim tokash nga Drejtoria e Bujqesis **500 leke**

### **➤ 2) TARIFA PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE & MALLRAVE DHE DHËNIEN E LEJEVE PËR USHTRIM AKTIVITETI NGA QENDRA E LIÇENSIMIT PRANË DREJTORISË SË RRUGEVE DHE TRANSPORTIT**

➤

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Tarifa në lekë</b>
<b>I</b>	<b>TRANSPORT UDHËTARËSH</b>		
	<u>Brenda vendit</u>		
1.	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse. ➤ Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për linjë Për mjet Për linjë Për mjet Për linjë	40000 leke/5 vjet 5000 leke/5 vjet 20000 leke/5 vjet
2.	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse. ➤ Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për mjet	7500 leke/5 vjet
3.	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut ose ndërmjet qarqeve. ➤ Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut ose ndërmjet qarqeve.		75000 leke/5 vjet 7500 leke/5vjet
		Për mjet	20000 leke/5 vjet

4.

22

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë
II	<b>TRANSPORT MALLRASH</b>		
1.	<u>Brenda vendit</u> Çertifikatë për transport për transport mallrash për llogari të vet . Çertifikatë për tërheqës.		5000 leke/vit 4000 leke/vit

- a) Për rastet e ndryshimeve në liçencë/çertifikatë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj, paguhet 30% e vlerës së plotë.
- Autorizim ditor në fushën e transportit të udhetareve **200 lekë**.
- Cmimi për dhenien e bllokut të udhëtimit për shërbime turistike ,në transportin rrugor të udhetareve brenda vendit me autobus në Bashkin Prrenjas **200 leke/fleta** .(udhezimi nr 8885 dt 07.11.2016 “për kriteret që duhet të plotësojnë subjektet në transportin rrugor turistik”)

#### **TARIFA TË INSPEKTORIATIT VENDOR TË MBROJTJES SË TERITORIT**

- Dhënie çertifikate pastërtie për firmat e ndërtimit (leje ndërtimi dhe leje shfrytëzimi) **1000 lekë**
  - Dhenie dëshmi penaliteti për firmat e ndërtimit **1000 leke**
- Struktura e ngarkuar vjelljen e kësaj tarife është IVMT në Bashkin Prrenjas.**

#### **• TARIFAT E SHERBIMIT PYJOR**

##### a) Tarifa e kullotjes së bagetive

Nr	Lloji i bagetive	Tipi i kullotes		Pyje që kullohen Leke/krere
		Dimerore Leke/krere	Verore Leke/krere	
1	Dhen	100	100	50
2	Dhi	100	80	100
3	Gjedh	800	800	60
4	Njethundrake	800	800	60

##### a) Tarifa e kositjes së barit dhe krasitjes së druve pyjore për gjedhe.

Nr	Emertimi	Tipi i kullotes		Pyje që kullohen Leke/dru
		Dimerore Leke/m2	Verore Leke/m2	
1	Kositje bari	0	1	10
2	Krasitje gjethi	0	0	10

##### b) Tarifa vjetore të përdorimit të sipërfaqes së tokës për ndërtimet provizore në fondin kullësorë nga fermeret që mbarshojnë bageti.

Nr	Lloji i ndërtimit	Tipi i kullotes	Pyje që
----	-------------------	-----------------	---------

		Dimerore Leke/m2/ vit	Verore Leke/m2/vit	kulloten Leke/m2/vit
1	qender stani rrethuar	50	50	50
2	Qender perpunim bulmeti	100	100	100
3	Ngrehine banimi per barinj	50	50	50
4	Mullinj,magazine	100	100	100

- c) Tarife per dru zjarri te thata,te rrezuara shkukur dhe thyer nga furtunat dhe zjarret te cilat do te transportohen vetem me kafshe , si dhe prerje gjethe dushku .1500 leke per cdo familje.

Struktura e ngarkuar me perllogaritjen e tarifave eshte Drejtoria e Pyjeve , per vjeljen e detyrimeve sektori i tatim - taksave .

- d) 2) **NDERMARJA E SHERBIMEVE MBESHTETESE TE ARSIMIT DHE ÇERDHES .**

- e) Tarifa e regjistrimit per here te pare per cdo femije ne kopesht dhe cerdhe per periudhen 01.01.2020-31.12.2020.

➤ Kopshti 1000 Leke/vit/femije

➤ Çerdhe 1000 Leke/vit/femije

➤ Tarife e menuse ditore te ushqimit kopeshte dhe cerdhe 110-150 leke/dita.

- f) Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e këtyre tarifave është ,Sektori i Fimances dhe sektori Arsimit Bashkia Prrenjas.

- g) **E. LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT,POLICIA BASHKIAKE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE .**

a. Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti :	
• transport udhëtarësh taksi (1+4)	1000 leke
• transport udhëtarësh taksi (1+8)	1000 leke
• mjete të tonazhit të lartë	2000 leke
• hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë,mjetet e transportit te mallrave ushqimore+industrial.	1000 leke
b. Mospajisje me liçensë për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse.	5000 leke

c. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	1000 leke
d. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	3000 leke
e. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	1000 leke
f. Mospajisje me leje për zenie të hapësirës publike •veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike	5000 leke
g. Mospajisje me leje për vendosje reklame : • e thjeshtë • elektronike	1000 leke 1000 leke
h. Mosmarrja e masave për izolimin e ambjentit për daljen e zhurmave nga ambjentet e lokaleve.	5000 leke

## 2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë :

a. Dëmtim rruge	2000 deri 20000 leke
b. Çarje rruge	2000 deri 20000 leke
c. Bllokim rruge	500 deri 5000 leke
d. Dëmtim bordure	500 deri 2000 leke
e. Dëmtim trotuari	500 deri 2000 leke
f. Çarje trotuari	500 deri 2000 leke
g. Bllokim trotuari	500 deri 2000 leke
h. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	5000 leke
i. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet : - persona juridikë - persona fizikë - qytetarë	5000 leke 3000 leke 1000 leke
a. Lidhje e pamiruar në rrjetin ajror	5000 leke
b. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	5000 leke
c. Dëmtim i ndriçuesve	1000 leke
d. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllave etj.	2000 leke
e. Dëmtim i traseve, kabllave dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave	5000 leke
f. Ndërhyrje në kuadrot elektrik public	2000 deri 5000 leke
<b>4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit :</b>	
a. Lidhje e pa miruar në tubacion	5000 deri 20000 leke

b. Dëmtim i pushtave	5000 leke
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje.	5000 leke
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	500 deri 5000 leke
b. Dëmtim, prerje e pemëve	500 deri 5000 leke
c. Zënie e hapësirës të gjelbër pa leje	500 deri 5000 leke
d. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash pa leje	500 deri 5000 leke
e. Vendosje posterash pa leje	500 deri 2000 leke
f. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate.	5000 leke
g. Dëmtimi i kanaleve vaditese dhe kulluse.	1000 deri 5000 leke
<b>6. Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë :</b>	
a. Për mishin e therur të tregëtuar të pa çertifikuar nga Inspektoriatin Veterinar.	1000 deri 5000 leke
b. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Bashkisë.	5000 deri 50000 leke
c. Në rast të mosmarrjes së masave për izolimin kafshëve të luksit.	2000 deri 5000 leke
<b>7. Te tjera gjopa për shërbim publik e privat</b>	
a. Dëmtim prone publike ose private	2000 deri 5000 leke
b. Lidhje të paligjshme	2000 deri 5000 leke

- Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas përcaktimit që bën Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjen administrative”.
- Mbeten në fuqi të gjitha gjobat e tjera që janë miratuar me ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.
- Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.
- Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Drejtoritë në Bashki.
- Mbeten në fuqi të gjitha taksat dhe tarifatat e tjera që janë miratuar me Ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.
- Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Prrenjas vetëm pasi të kenë paguar para zbardhjes së lejes së ndërtimit detyrimet përkatëse për selinë administrative, detyrimet për “çdo kantier ndërtimi” si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. **Struktura e ngarkuar për dhënie leje ndërtimi, përllëgaritjen e vlerës së taksave dhe tarifave, vjeljen e tyre dhe penalitetet është Drejtoria e Urbanistikës pranë Bashkisë Prrenjas**

- Të gjitha subjektet që do aplikojnë pranë QKB për pezullim të aktivitetit nga data e aplikimit për pezullim deri në datën e aktivizimit nuk do të llogariten taksat dhe tarifat lokale.
- Përfshihen nga pagesa të gjitha rastet e parashikuara me Ligj.
- **Paketa fiskale 2020 është hartuar në bashkëpunim me drejtorin e financave ,drejtorin e urbanistikës ,drejtorin e shërbimeve ,drejtorin e transportit rrugor, drejtorin e pyjeve dhe kullotave ,drejtorin e bujqësisë ,policin bashkiake e tj.**

#### Ankimimet

- Cdo tatimpagues që e sheh të padrejte vlerësimin e detyrimit tatimor apo gjobat e vendosura nga sektori i tatim-taksave të Bashkisë , ka të drejtë të ankohet tek komisioni i apelimit tatimor të emruar nga kryetari i bashkisë.
- Ankesa duhet të bëhet me shkrim brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit dhe të shoqërohet me dokumenta përkatës .
- Përgjigja e ankesës do të merret me shkrim nëpërmjet postës , sipas vendimit të dale nga komisioni i apelimit tatimor , mbështetur në rregulloren e apelimit tatimor të miratuar nga keshilli bashkiak .
- Një kopje të vendimit, komisioni i apelimit tatimor e dërgon në zyrën e tatim-taksave për ndryshimin ose jo të akt-detyrimit.

2- Ngarkohet për zbatimin këtij vendimi Zyra e tatim-taksave

3- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015

**SEKRETARI I KESHILLIT  
AUREL KARRIQI**

**KRYETARI I KESHILLIT  
FLUTURA HAKA**

